



**KONTRATË ANËTARËSIMI INDIVIDUAL NË FONDIN E PENSIONIT
PRIVAT ME PJESËMARRJE TË HAPUR ALBSIG**

Mbështetur në nenet 62 të ligjit nr. 76/2023 “Për Fondet e Pensionit Privat” dhe rregullores nr. 2, datë 31.01.2024 “Për përcaktimin e elementëve të kontratës së anëtarësimit, të deklaratës së pranimit të pjesëmarrjes, të kontratës së administrimit të aktiveve të shoqërisë administruese dhe përmbajtjes e strukturës së prospektit të fondit”, sot më datë ____/____/____, në _____ nënshkruhet kjo kontratë:

TË DHËNAT E FONDIT TË PENSIONIT PRIVAT:

Fondi i Pensionit Privat me pjesëmarrje të hapur “Albsig”, i licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) me Vendim nr. 210, datë 22.11.2019, në monedhën bazë Lekë.

TË DHËNAT E SHOQËRISË ADMINISTRUESE:

ALBSIG INVEST SH.A - Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive, me NUIS: L92208025J, me seli në adresën: Bulevardi “Bajram Curri”, Downtown One, Kati 16, Tiranë, Shqipëri, e themeluar më datë 03/10/2019, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit më datë 08.10.2019, licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) me Licencë nr. 5, datë 22/11/2019, përfaqësuar nga Z. Elton KORBI, Administrator i Përgjithshëm (këtu e më poshtë “Shoqëria Administruese”).

dhe;

TË DHËNAT E A:

Emër Atësi Mbiemër: _____, Numër Personal/Numër Pasaporte: _____
(kopja e së cilës i bashkëlidhet deklaratës), Datëlindja: ____/____/____, Vendlindja: _____,
Shtetësia: _____, Vendbanimi i përhershëm dhe/ose i përkohshëm: _____,
Adresa e banimit: _____, Tel./Mob.: _____,
E-mail: _____, Shuma e kontributit: _____ lekë (ose %), Frekuenca e
pagesës: _____, Mënyra e pagesës: _____, Burimi i të ardhurave: _____.

ANËTARI:

ALBSIG INVEST SH.A:

Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit
Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive,
përfaqësuar nga Administratori i Përgjithshëm:

(Emër, Mbiemër, Firmë)

(Emër, Mbiemër, Firmë, Vullë)





NENI 1 - OBJEKTI DHE BAZA LIGJORE

- Objekt i kësaj kontrate është rregullimi i marrëdhënieve midis Anëtarit të Fondit ("Anëtari") dhe Shoqërisë Administruese ("Shoqëria"), që rrjedhin nga anëtarësimi i tij në Fondin e Pensionit Privat me pjesëmarrje të hapur "Albsig" ("Fondi"), i licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) me Vendim nr. 210, datë 22.11.2019, në monedhën bazë Lekë.
- Kjo kontratë mbështetet në nenin 62, të ligjit nr. 76/2023 "Për Fondet e Pensionit Privat" ("Ligji"), dhe akteve nënligjore të tij, si dhe Prospektin e Fondit, i cili i bashkëlidhet kësaj kontrate si dhe në aktet e tjera të brendshme të Shoqërisë Administruese.

NENI 2 - ANËTARËSIMI

- Çdo person mund të anëtarësohet në Fond duke lidhur një kontratë anëtarësimi me Shoqërinë Administruese.
- Anëtari, duke nënshkruar këtë kontratë, konfirmon se është njohur dhe ka kuptuar plotësisht kushtet e kësaj kontrate, Prospektin e Fondit të hartuar nga Shoqëria Administruese si dhe tarifën e aplikuar prej saj.
- Shoqëria Administruese do të hapë një llogari personale për çdo Anëtar, sipas kontratës së lidhur.

NENI 3 - PAGESA E KONTRIBUTEVE

- Shuma e kontributit përcaktohet nga çdo anëtar, por jo më pak se 1,000 (njëmijë) lekë në muaj.
- Kontributit do të derdhen nga Anëtari ose në emër të tij në numrin e llogarisë së Fondit **IBAN AL76 2061 1004 0000 1003 2114 7100** pranë Bankës së Tiranës sh.a., e cila do të kryejë funksionin e Depozitarit të Fondit sipas Ligjit.
- Anëtari zgjedh frekuencën e pagesës së kontributeve e cila mund të jetë mujore, me një periodicitet tjetër, ose si një shumë totale. Pavarësisht nga frekuenca e pagesës së kontributeve e zgjedhur nga Anëtari, në çdo rast, shuma do të jetë në përputhje me pikën 1 të këtij neni.
- Asetet e Anëtarit në Fond përbëhen nga kontributet në para, të bëra në emër dhe për llogari të Anëtarit dhe nga kthimi i investimit të bërë me këto kontribute, pas zbatimit të zbritjeve të nevojshme, sipas dispozitave ligjore, Prospektit dhe kontratës.
- Shoqëria Administruese konverton në kuota pensioni pagesat në formë kontributi dhe asetet e transferuara nga një fond tjetër sipas çmimit të kuotës të ditës së mbërritjes së pagesës në llogarinë e Fondit. Çdo kuotë pensioni përfaqëson një pjesë përpjesëtimore pronësie në secilin nga asetet e Fondit. Vlera totale e kuotave në Fond është gjithmonë e barabartë me vlerën totale neto të aseteve të Fondit.
- Procedura e detajuar e konvertimit të kontributeve të paguara nga Anëtari në kuota përcaktohet në Prospektin e Fondit të hartuar nga Shoqëria Administruese, i cili është pjesë përbërëse e kësaj kontrate.
- Nëse Anëtari (ose në emër dhe për llogari të tij) ndërpret pagesën e kontributeve, ai mbetet anëtar në Fond me të njëjtat të drejta si anëtarët e tjerë të Fondit dhe nuk ka asnjë penalitet.
- Anëtari mund të ndërpresë, të zvogëlojë ose të rrisë kontributet individuale në çdo kohë. Pavarësisht shumës dhe periodicitetit të kontributeve të vendosur në këtë kontratë, shuma e kontributeve për t'u konvertuar në kuota do konsiderohet shuma aktuale në datën e mbërritjes në llogarinë e Fondit.

NENI 4 - POLITIKA E INVESTIMIT

- Asetet e Fondit do të investohen sipas parimit të sigurisë, diversifikimit dhe mbajtjes së likuiditetit të përshtatshëm për investimet afatgjata.
- Portofoli i Fondit do të përbëhet kryesisht nga tituj afatgjatë (letra me vlerë me maturim më të lartë se një vit) të emetuara dhe garantuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.
- Fondi është i ekspozuar kryesisht nga rreziku i normave të interesit, i cili përcaktohet si ndryshimi i normave të interesit të obligacioneve afatgjata në të cilat investon Fondi. Ndryshimi i normave të interesit ndikon mbi të ardhurat e Fondit dhe vlerën neto të aseteve të Anëtarit. Rreziku i kredisë që mbart Fondi është lidhur ngushtë me aftësinë paguese të Shtetit Shqiptar, në obligacionet e të cilat investon Fondi, dhe përfaqëson rrezikun më të ulët të kredisë në krahasim me investimet e tjera në tregun e kapitalit.
- Karakteristikat e politikës së investimit paraqiten në Prospektin e Fondit të hartuar nga Shoqëria Administruese, i cili është pjesë përbërëse e kësaj kontrate.
- Anëtari, pasi bie dakord me këtë kontratë dhe Prospektin e Fondit, merr përsipër rrezikun e mundshëm të investimit në Fond.

NENI 5 - BANKA DEPOZITARE

- Shoqëria Administruese ka lidhur kontratë me Bankën e Tiranës sh.a, me seli në adresën Rruga "Ibrahim Rugova", Tiranë, Shqipëri, e regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar me Vendimin nr. 12718, datë 03.11.1995 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, NUIS: J61924008V, e cila sipas ligjit do të jetë Depozitari për asetet e Fondit.
- Depozitari në bazë të Vendimit nr. 23, datë 24.03.2010 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, është licencuar për të ofruar shërbime kujdestarie, depoziti-

mi dhe të besimit, si dhe është miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për të ofruar shërbime depozitimi për asetet e fondeve të pensionit dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive me Licencë nr. 2, datë 06.06.2019.

- Depozitari do të jetë përgjegjës për ruajtjen e Aseteve në Fond. Depozitari kontrollon administrimin e aseteve të Fondit nga Shoqëria Administruese, në përputhje me dispozitat e kontratës, Prospektit si dhe të legjislacionit në fuqi.
- Depozitari është një entitet tërësisht i pavarur nga Shoqëria Administruese dhe çdo palë tjetër të lidhur me të, i cili siguron që të gjitha të ardhurat e Fondit do të shpërndahen në përputhje me Ligjin dhe kontratën.

NENI 6 - TË DREJTAT DHE DETYRIMET E SHOQËRISË ADMINISTRUERE:

Shoqëria Administruese merr përsipër:

- Të administrojë me efektivitet asetet e Fondit, nëpërmjet diversifikimit të investimeve, me synim rritjen e aseteve të anëtarëve.
- Të ofrojë pensione dhe përfitime të tjera tek anëtarët, sipas kushteve dhe procedurave ligjore.
- Të informojë çdo Anëtar lidhur me Prospektin e Fondit të hartuar nga Shoqëria Administruese përpara se të nënshkruajë kontratën.
- Të raportojë tek Anëtari vlerën neto të aktiveve të Fondit.
- Me kërkesë të Anëtarit të mundësojë një vërtetim mbi gjendjen e llogarisë individuale.
- Të pajisë Anëtarin me kredenciale për të parë gjendjen e llogarisë së tij individuale online, në çdo kohë.
- Të paktën 1 (një) herë në vit, të informojë çdo Anëtar për gjendjen e llogarisë së pensionit në mënyrë elektronike. Anëtarit i jepet një kopje fizike me kërkesë të tyre.
- Të respektojë konfidencialitetin e llogarisë individuale të çdo Anëtarit dhe të japë informacion mbi asetet vetëm tek anëtarët e Fondit, personat e autorizuar nga Anëtari, si dhe në rastet e tjera të parashikuara nga Ligji.
- Të informojë në çdo kohë anëtarët për sa i përket ndryshimeve në politikat e investimit si dhe rregulloret përkatëse që krijojnë efekte për Anëtarin.
- Të kryejë transferimin e aseteve, mbështetur në kërkesën me shkrim të Anëtarit, si në rastin e transferimit në një Fond tjetër të administruar nga e njëjta Shoqëri Administruese, ashtu edhe në rastin e transferimit në një Fond të administruar nga një Shoqëri Administruese tjetër.
- Shoqëria Administruese publikon sipas afateve në Ligj, pasqyrat financiare, raportet vjetore, vlerat neto të aktiveve, kuotat totale të Fondit, etj.

NENI 7 - TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ANËTARIT

Anëtari ka të drejtat e mëposhtme:

- Anëtari brenda 30 ditëve kalendarike nga data e kryerjes së kontributit të parë në llogarinë e Fondit mund të zgjidhë pa penalitet kontratën e anëtarësimit në Fond, pa përmendur arsye të veçanta, duke njoftuar me shkrim ose me postë elektronike Shoqërinë Administruese. Shoqëria Administruese duhet t'i kthejë Anëtarit vlerën e kontributeve të paguara në llogari, përfshirë kthimin nga investimi, përjashtuar tarifën e administrimit për atë periudhë.
- Të ketë në çdo kohë pronësinë e aseteve të investuara në Fond.
- Të përfitojë pagesën e menjëhershme të vlerës neto të aseteve ose pagesat periodike në formë pensioni sipas kushteve dhe procedurave ligjore;
- Të informohet të paktën 1 (një) herë në vit, mbi gjendjen e llogarisë së pensionit në mënyrë elektronike.
- Të pajiset me dokumentin që vërteton pagesën e kontributeve në llogarinë e tij dhe konvertimin e tyre në kuota.
- Të transferojë asetet e akumuluar në një Fond tjetër, i cili administrohet nga e njëjta ose nga një shoqëri administruese tjetër. Në rastin e transferimit të aseteve, Anëtari përfundon kontratën e mëparshme si dhe lidh një kontratë anëtarësimi në Fondin tjetër.
- Të ketë një Fond Pensioni të trashëgueshëm në rastet kur Anëtari humb jetën.
- Të përcaktojë masën e kontributeve që do të paguajë, frekuencën dhe mënyrën e pagesës së kontributit, të ndryshojë këtë shumë si dhe dinamikën e pagesës së kontributeve, sipas zgjedhjes.

Anëtari ka detyrimet e mëposhtme:

- Të lexojë me vëmendje dhe kuptojë Prospektin e Fondit dhe këtë kontratë.
- Të informojë menjëherë dhe jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë Shoqërinë Administruese lidhur me ndryshimet e kushteve që kanë të bëjnë me anëtarësimin në Fond.
- Të informojë menjëherë Shoqërinë Administruese për çdo ndryshim në të dhënat personale.

NENI 8 - TRANSFERIMI I ASETVE TË FONDIT

- Anëtari ka të drejtë që në çdo kohë të transferojë asetet e veta në një fond tjetër pensioni, i cili administrohet nga e njëjta shoqëri administruese ose nga një tjetër shoqëri administruese. Nëse anëtari kërkon të transferojë asetet e tij në një fond tjetër pensioni, duhet të paraqesë pranë Shoqërisë Administruese një kërkesë me shkrim për të transferuar asetet tek fondi i ri i pensionit shoqëruar me të gjithë dokumentacionin e kërkuar, i cili përcaktohet në rregulloren e miratuar nga Shoqëria Administruese.





2. Në rastin e transferimit të aseteve të anëtarit në një shoqëri tjetër administruese, Shoqëria Administruese me marrjen e kërkesës me shkrim nga anëtari për transferim të aseteve njofton brenda 5 (pesë) ditëve pune shoqërinë tjetër administruese për kërkesën e anëtarit për transferimin e aseteve.
3. Shoqëria Administruese ekzekuton transferimin e aseteve në llogari brenda 10 (dhjetë) ditëve pune nga data e marrjes së konfirmimit të shoqërisë administruese tjetër.
4. Në rastin e transferimit brenda të njëjtës Shoqëri Administruese, transferimi ekzekutohet brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e marrjes së kërkesës nga Anëtari.
5. Brenda 5 (pesë) ditëve pune nga dita e transferimit të llogarisë, shoqëria informon Anëtarin për ekzekutimin e transferimit, vlerën totale neto të aseteve të transferuara, përfshirë kthimin nga investimi, si dhe detyrimet e tjera.
6. Transferimi i aseteve në llogarinë e Anëtarit në një fond pensioni të administruar nga një shoqëri tjetër administruese shoqërohet me një komision transferimi nga fondi deri në masën 0.5% të shumës së transferuar.
7. Transferimi i aseteve në një fond tjetër pensioni të administruar nga e njëjta shoqëri administruese nuk shoqërohet me komision transferimi.

NENI 9 - PAGESA E PËRFITIMEVE

1. Anëtari i Fondit të Pensionit, sipas zgjedhjes, ka të drejtë të marrë pagesën e menjëhershme të vlerës neto të aseteve në llogarinë e vet, ose pagesat periodike në formë pensioni, që i përgjigjen kësaj vlere pa penalitet kur:
 - 1.1. mbush moshën e pensionit të parashikuar me ligj për sistemin e pensionit të detyrueshëm shtetëror që zbatohet për atë Anëtar;
 - 1.2. 5 vjet përpara se të mbushë moshën e pensionit të parashikuar me ligj për sistemin e pensionit të detyrueshëm shtetëror që zbatohet për atë Anëtar;
 - 1.3. bëhet i paafte për punë në mënyrë të përhershme dhe që vërtetohet me dokumentacion në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Pagesa e menjëhershme e vlerës neto të aseteve do të kryhet në bazë të kërkesës me shkrim të Anëtarit, në llogarinë e tij bankare, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga marrja e kërkesës.
3. Anëtari gëzon të drejtën e përdorimit të vlerës neto të aseteve në llogarinë e tij apo të një pjese të saj për blerjen e një kontrate të sigurimit të jetës në formë "të përvitshme", të ofruar nga një shoqëri e sigurimit të jetës, e licencuar nga AMF-ja. Vlera neto e aseteve në llogarinë e Anëtarit të Fondit do të transferohet te shoqëria e sigurimit të jetës sipas opsionit të zgjedhur nga Anëtari i Fondit. Shoqëria administruese njofton shoqërinë e sigurimit të jetës për kërkesën e Anëtarit të Fondit dhe merr një konfirmim nga kjo e fundit për blerjen e kontratës së sigurimit të jetës në formë "të përvitshme".
4. Anëtari i Fondit mund të vendosë të marrë pagesa periodike mujore në formë pensioni të zgjidhura në kohë, jo më pak se 2 vjet, mbështetur në një marrëveshje të veçantë të lidhur midis Anëtarit dhe Shoqërisë Administruese, shoqëruar me të gjithë dokumentacionin që vërteton plotësimin e kushteve për të bërë tërheqjen, kur Anëtari plotëson kushtet e parashikuara të pikës 1 të këtij neni.
5. Me qëllim përfitimit e pagesës së të gjithë aseteve të veta në Fond, Anëtari i paraqet një kërkesë me shkrim Shoqërisë Administruese, shoqëruar me të gjithë dokumentacionin që vërteton plotësimin e kushteve për të bërë tërheqjen, të përcaktuar në rregulloren e miratuar nga Shoqëria Administruese.
6. Nëse Anëtari zgjedh të marrë pagesën e pensionit në format e pikës 2, 3 dhe 4 të këtij neni, nuk mund të vijojë të derdhë kontribute në Fond.

NENI 10 - TËRHEQJA E PARAKOHSHME

1. Anëtari ka të drejtë që të tërheqë asetet nga llogaria individuale e Fondit përpara plotësimit të kushteve të parashikuara në nenin 9 të kontratës. Shoqëria Administruese kryen pagesën e vlerës neto të aseteve në llogarinë e Anëtarit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga marrja e kërkesës së Anëtarit për tërheqje të parakohshme.
2. Në rastin e tërheqjes së parakohshme, Shoqëria Administruese do të aplikojë penalitete, të cilat parashikohen në Ligj dhe do të llogariten mbi vlerën neto të aseteve dhe më konkretisht:
 - 2.1. 2% e aseteve të tërhequra, për çdo tërheqje të parakohshme të kryer pas 20 vitesh nga data e kontributit të parë;
 - 2.2. 5% e aseteve të tërhequra, për çdo tërheqje të parakohshme të kryer në periudhën kohore që fillon pas 10 vitesh nga data e kontributit të parë deri në 20 vjet nga data e kontributit të parë, përfshirë edhe vitin e 20-të;
 - 2.3. 10% e aseteve të tërhequra, për çdo tërheqje të parakohshme të kryer në periudhën kohore që fillon pas 5 vitesh nga data e kontributit të parë deri në 10 vjet nga data e kontributit të parë, përfshirë edhe vitin e 10-të;
 - 2.4. 15% e aseteve të tërhequra, për çdo tërheqje të parakohshme të kryer në periudhën kohore deri në 5 vjet nga data e kontributit të parë, përfshirë edhe vitin e 5-të.
3. Në rastin e vdekjes së Anëtarit penaliteti i tërheqjes së parakohshme nuk aplikohet.

NENI 11 - PAGESA E ASETEVE NË RASTIN E HUMBES SË JETËS SË ANËTARIT

1. Në rastin kur Anëtari ndërron jetë gjatë periudhës së akumulimit apo përpara se të marrë pagesën e të gjithë aseteve të veta, asetet në llogarinë e tij/saj i shpërndahen trashëgimtarëve në përputhje me dispozitat ligjore që rregullojnë trashëgiminë.

NENI 12 - TARIFAT E SHOQËRISË ADMINISTRUESE

1. Shoqëria Administruese do të aplikojë tarifën e mëposhtme:
 - 1.1. Komisioni vjetor i administrimit të Fondit do të jetë 2.5% në vit e vlerës neto të aseteve të Fondit. Komisioni do mbahet çdo ditë dhe do të paguhet çdo muaj si shumë e vlerave ditore për atë muaj.
2. Në rastin e transferimit të aseteve nga Anëtari në një Fond tjetër të menaxhuar nga një Shoqëri Administruese tjetër, tarifa që do të aplikohet do të jetë 0.5% e shumës së transferuar.
3. Çdo rritje e tarifave që do të aplikohet nga Shoqëria Administruese, do t'i njoftohet anëtarëve në Fond të paktën 6 (gjashtë) muaj përpara se të hyjë në fuqi.
4. Shoqëria Administruese ka të drejtën e mosaplikimit të një ose disa komisioneve/tarifave për një afat të caktuar, nëse këto komisione/tarifa ndikojnë në mënyrë disproporcionale në performancën e Fondit.

NENI 13 - TRAJTIMI FISKAL

1. Kontributi i bërë nga çdo anëtar zbritet nga të ardhurat personale të tij për efekt tatimi. Kufiri maksimal mujor, për lehtësinë tatimore, është deri në nivelin e pagës minimale të miratuar në shkallë vendi.
2. Kthimi i investimit, përfshirë fitimin nga kapitali prej investimeve të kryera me asetet e fondit të pensionit nuk i nënshtrohen tatimit.
3. Pagesat e marra nga Anëtari i Fondit të Pensionit në mënyrë periodike mujore taten në përputhje me legjislacionin në fuqi për tatimin mbi të ardhurat në Republikën e Shqipërisë.
4. Pagesat e marra nga Anëtari i Fondit të Pensionit në mënyrë të menjëhershme përpara afatit 2-vjeçar, taten me normën në fuqi të tatimit sipas përcaktimeve të legjislacionin në fuqi për tatimin mbi të ardhurat personale.
5. Tërheqja e parakohshme taten me normën në fuqi të tatimit mbi të ardhurat personale për vlerën e plotë të tërhequr para kohe, përfshirë kontributet.
6. Blerja e një kontrate të sigurimit të jetës në formë "të përvitshme" nga një shoqëri sigurimi jete, që sjell një produkt me të ardhura të rregullta, periodike, do të trajtohet me të njëjtat lehtësi fiskale si pagesat periodike në formë pensioni të parashikuara në pikën 3 të këtij neni.

NENI 14 - KOHËZGJATJA E KONTRATËS

1. Kjo kontratë lidhet për një afat të pacaktuar dhe do të sjellë pasojë ligjore vetëm pasi të jetë bërë pagesa e parë e kontributit.
2. Kontrata përfundon:
 - 2.1. Kur të gjitha asetet e Anëtarit janë transferuar në një tjetër Fond Pensioni;
 - 2.2. Në rastin kur Anëtari zgjedh të nënshkruajë një marrëveshje të veçantë me Shoqërinë Administruese për pagesat e pensionit në formë periodike;
 - 2.3. Nëse anëtari ka zgjedhur të marrë pagesën e pensionit nëpërmjet një shoqërie sigurimi të jetës në formë "të përvitshme";
 - 2.4. Në rastin e tërheqjes së parakohshme;
 - 2.5. Në rastin e humbjes së jetës së Anëtarit.

NENI 15 - ZGJIDHJA E KONTRATËS DHE MOSMARRËVESHJEVE

1. Pala që do të zgjidhë kontratën duhet të njoftojë me shkrim palën tjetër të paktën 3 muaj përpara nga data e zgjidhjes së kontratës.
2. Çdo mosmarrëveshje mes palëve të kësaj kontrate do të zgjidhet me mirëkuptim, në të kundërt, kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të jetë Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë.

NENI 16 - DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

1. Ndryshimet dhe shtesat në kontratë do të bëhen me mirëkuptim të palëve si dhe do të marrin miratimin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF).
2. Kjo kontratë hartohet në gjuhën shqipe në kopje origjinale, nga një për secilën palë, përfshirë edhe personin e tretë që paguan kontributet në emër të Anëtarit të Fondit.
3. Kjo kontratë hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët.
4. Për sa më sipër autorizoj Shoqërinë Administruese "Albsig Invest", për përpunimin e të dhënave personale, në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale". Me përpunim të dhënash në kontekstin e këtij autorizimi bazuar në Ligjin Nr. 9887, do të kuptojmë "grumbullimin, regjistrimin, ruajtjen, renditjen, përshtatjen, ndreqjen, këshillimin, shfrytëzimin, përdorimin, bllokimin, fshirjen ose shkatërrimin, transmetimin" etj.
5. Autorizoj Shoqërinë Administruese "Albsig Invest" sh.a, për deklarimin e të dhënave të mia personale, pranë institucioneve përkatëse të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

